

Spar Albania Sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare
për vitin ushtrimor të mbyllur
më 31 dhjetor 2022**

PËRMBAJTJA

**OPINIONI I AUDITUESIT TE PAVARUR
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË**

1.	INFORMACION I PERGJITHSHËM	5
2.	PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL	5
3.	GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME	17
4.	STANDARDE TË REJA DHE AMENDIME	18
5.	TË ARDHURA NGA KONTRATAT ME KLIENTËT	20
6.	TË ARDHURA TË TJERA.....	20
7.	KOSTOT E SHITJEVE	21
8.	SHPENZIME PËR MATERIALE.....	21
9.	SHPENZIME PËR SHËRBIME	21
10.	SHPENZIME PËR PAGA DHE DETYRIME	21
11.	SHPENZIME TË TJERA	22
12.	FITIMI/(HUMBJE) NGA KËMBIMET VALUTORE, NETO	22
13.	TË ARDHURA (SHPENZIME) FINANCIARE, NETO	22
14.	TATIMI MBI FITIMIN	22
15.	AKTIVE (DETYRIME) TATIMORE TE SHTYRA	23
16.	AKTIVE AFATGJATA MATERIALE	24
17.	AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE	25
18.	E DREJTA E PËRDORIMIT DHE DETYRIMET E QIRAVE.....	25
19.	AKTIVE AFATGJATA FINANCIARE.....	26
20.	INVENTARI.....	26
21.	LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE TË TJERA	27
22.	MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE TË TYRE	28
23.	KAPITALI AKSIONAR	28
24.	HUAMARRJE.....	29
25.	LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA	29
26.	PALËT E LIDHURA.....	30
27.	OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT FINANCIAR	30
28.	ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA.....	32
29.	ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA.....	32

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionerët e Spar Albania sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Spar Albania sh.p.k. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar Auditimit (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2022, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2022 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare (vazhdim)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër. Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.


Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është me i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetedijshme e gjithë informacionit, keq përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmerinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.


Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Spar Albania sh.p.k. përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri


1 qershor 2023
Tiranë, Shqipëri



Alba Pine
Auditues Ligjor



Spar Albania Sh.p.k.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga shitja e mallrave	5	9,112,659	7,676,157
Të ardhura nga shitja e njërive ndërtimore	5	1,460	50,317
Të ardhura të tjera nga kontrata me klientët	5	186,208	186,107
Totali i të ardhurave nga kontratat me klientët		9,300,327	7,912,582
Të ardhura të tjera	6	55,580	19,659
Totali i të ardhurave		9,355,907	7,932,241
Kostot e shitjeve	7	(7,488,406)	(6,339,808)
Shpenzime për materiale	8	(35,851)	(35,026)
Shpenzime për shërbime	9	(406,937)	(362,609)
Shpenzime për personeli	10	(601,509)	(449,624)
Shpenzime të tjera	11	(154,966)	(121,580)
Amortizime dhe zhvlerësime	16-17	(442,155)	(383,345)
Fitim/(humbje) nga këmbimet valutore, neto	12	85,812	41,080
Totali i shpenzimeve		(9,044,012)	(7,650,912)
Shpenzime financiare, neto	13	(61,157)	(64,112)
Fitimi para tatimit		250,738	217,217
Tatim mbi fitimin	14	(42,570)	(39,619)
Fitimi neto për vitin		208,168	177,598
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		208,168	177,598

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare në faqet nga 5 në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Spar Albania Sh.p.k.*(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	
Aktivët			
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	16	443,927	341,851
Aktive afatgjata jomateriale	17	8,188	11,462
Emri i mirë	17	103,630	103,630
E drejta e përdorimit të aktiveve	18	1,520,187	1,548,248
Aktive financiare afatgjata	19	9,943	13,054
Aktive tatimore të shtyra	15	3,320	835
Totali i aktiveve afatgjata	2,089,194	2,019,080	
Aktivët afatshkurtra			
Inventari	20	977,332	837,160
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	21	402,556	365,091
Llogari të arkëtueshme të tjera	21.a	135,761	110,140
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	22	422,781	425,792
Totali i aktiveve afatshkurtra	1,938,430	1,738,183	
Totali i aktiveve	4,027,624	3,757,263	
Kapitali dhe Detyrimet			
Kapitali			
Kapitali aksionar	23	76,608	101,048
Fitimi i mbartur		208,168	177,598
Totali i kapitaleve të veta	284,775	278,646	
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huamarrje afatgjata	24	173,313	97,864
Detyrime për qiratë afatgjata	18	1,179,605	1,278,592
Totali i detyrimeve afatgjata	1,352,918	1,376,456	
Detyrimet afatshkurtra			
Huamarrje afatshkurtra	24	90,319	109,349
Llogari të pagueshme dhe të tjera	25	1,991,513	1,706,905
Detyrime për qiratë afatshkurtra	18	308,099	285,907
Totali i detyrimeve afatshkurtra	2,389,931	2,102,161	
Totali i detyrimeve	3,742,849	3,478,617	
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	4,027,624	3,757,263	

Këto pasqyra financiare dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare në faqet nga 5 në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare janë autorizuar nga drejtimi më 01.06.2023 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Elona Mema

Administratore

Elona Mema



Ani Hafizi

Drejtoreshë Financiare

Ani Hafizi

Spar Albania Sh.p.k.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Kapitali themeltar	Fitimi i mbartur	Totali i kapitalit
Gjendja më 1 janar 2021	217,157	56,158	273,315
Shpërndarja e dividendit	-	(56,158)	(56,158)
Zvogëlim në kapital	(116,109)	-	(116,109)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	177,598	177,598
Gjendja më 31 dhjetor 2021	101,048	177,598	278,646
Shpërndarja e dividendit	-	(177,598)	(177,598)
Zvogëlim në kapital	(24,440)	-	(24,440)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	208,168	208,168
Gjendja më 31 dhjetor 2022	76,608	208,168	284,776

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare në faqet nga 5 në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese		
Fitimi para tatimit	250,738	217,217
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve afatgjata	16-17 139,217	122,873
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	18 302,939	260,472
Provizjoni i inventarit	20 5,346	1,541
Rimarrje nga humbje e pritshme nga mosarketimet	21 1,406	1,125
Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	14 -	11,437
Humbja nga shitja e aktiveve afatgjata	16-17 1,641	1,024
Zhvlerësime inventari	11 78,811	43,569
Përdorim i materialeve për qëllime të brendshme	11 26,944	23,467
Shpenzime interesi	13 9,589	12,735
Te ardhura nga interesi	13 (71)	(308)
Shpenzim interesi për detyrime të qirave	18 51,639	51,684
Të ardhura nga falja e detyrimit të qirasë	18 (2,077)	(157)
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:		
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	21 (59,885)	30,712
Ndryshimi në inventarë	20 (251,274)	(141,974)
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	25 292,001	218,145
Interes i paguar	13 (9,589)	(12,735)
Interes i arkëtuar	13 71	308
Tatimi fitimi i paguar	14 (53,944)	(10,210)
Flukset e gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit	783,502	830,925
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	17 (216)	(8,554)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	16 (242,915)	(150,772)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	16 3,471	1,041
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese	(239,660)	(158,285)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese		
Dividend të paguar	23 (177,598)	(56,158)
Pakesimi dhe shperndarja e kapitalit	23 (24,440)	(116,109)
Lëvrim nga huatë e marra	24 181,143	-
Pagesa të huave të marra	24 (124,724)	(361,693)
Pagesa e principalit për detyrime të qirave	18 (349,595)	(270,827)
Pagesa e interesit për detyrime të qirave	18 (51,639)	(51,684)
Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese	(546,853)	(856,471)
Rritja e parasë në arkë dhe në bankë	(3,011)	(183,832)
Paraja në arkë dhe në bankë më 1 janar	425,792	609,624
Paraja në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor	422,781	425,792

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare në faqet nga 5 në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Spar Albania Sh.p.k.

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare të mbyllura deri më 31 dhjetor 2022

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHËM

Shoqëria Spar Albania sh.p.k. (“Shoqëria” ose “Spar Albania”) është themeluar më datë 1 prill 2015 dhe është regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me NIPT L51603008A. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakut i vetëm Balfin sh.p.k., zotërues i 100% të kuotave. Z. Samir Mane është zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë Balfin sh.p.k.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: tregtimi i mallrave me shumicë e pakicë, import-eksport, etj., sipas objektit të veprimtarisë të përcaktuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Gjatë vitit 2022 Shoqëria ka pakësuar kapitalin e saj me 24,440 mijë lekë. Më datë 31 dhjetor 2021 Shoqëria zotëron një kapital prej 76,608 mijë lekë, ku numri i pjesëve është 1 (një) dhe pjesëmarrja në kapital 100%.

Administratore e Shoqërisë është Znj. Elona Mema, me afat emërimi deri më 1 prill 2026.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022 është 943 punonjës (2021: 857 punonjës).

Zyra qendrore e shoqërisë është: Selia Brunes Space, Qendra Tregtare Tirana East Gate, Rruga Nacionale Tirane - Elbasan, Farkë, Tiranë, Shqipëri.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17 datë 16.01.2019, në mbështetje të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, një subjekt mund të klasifikohet i rëndësishëm për interesin e publikut (NIP) për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre. Shoqëria është klasifikuar si NIP për shkak të numrit të punonjësve dhe vlerës së aseteve, të ardhurave.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

Parimi i vijueshmërisë

Drejtimi i Shoqërisë ka bërë një vlerësim të aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, dhe mendon se Shoqëria zotëron burime financiare të mjaftueshme për të vazhduar veprimtarinë e saj për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare vazhdojnë të përgatiten mbi parimin e vijueshmërisë.

2.2 Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë Shqiptar (“lek”), e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Me përjashtim të rasteve kur është specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur në lekë është rrumbullakosur në mijëshe.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat që rezultojnë nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kurs të ndryshëm nga ato që janë konvertuar në njohjen fillestare gjatë periudhës ose në pasqyra të mëparshme financiare, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, në periudhën që ato krijohen. Kurset e mëposhtme janë aplikuar gjatë vitit:

	<u>Kursi mesatar</u>		<u>Kursi në datën e raportimit</u>	
	<u>2022</u>	<u>2021</u>	<u>2022</u>	<u>2021</u>
EUR / LEK	118.92	122.44	114.23	120.76
USD / LEK	113.15	103.54	107.05	106.54

2.4 Të ardhurat nga kontratat me klientët

Shoqëria është e angazhuar në shitjen me pakicë në markete dhe supermarkete të artikujve ushqimorë dhe jo ushqimorë, shërbime të ndryshme, si dhe njëkohësisht dhe shitjen e njësisve të ndërtimit që ajo zotëron (apartamente, dyqane, garazh, depo etj.) që pritet të përfundojë në vitin 2023.

Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve transferohet te klienti në një shumë që reflekton shumën që Shoqëria pret në këmbim të transfertës të këtyre mallrave ose shërbimeve për një klient.

Të ardhurat nga shitja në markete dhe supermarkete

Shoqëria është e angazhuar me shitjen e artikujve të ndryshëm ushqimorë dhe jo ushqimorë me pakicë në markete dhe supermarkete. Këto produkte faturohen mbi bazën e një liste çmimesh të përcaktuar.

Të ardhurat kryesore nga shitja në markete dhe supermarkete janë si më poshtë:

- Të ardhura nga produkte ushqimore të paketuara, të freskëta, detergjentë dhe të tjera;
- Të ardhura nga produkte jo ushqimore dhe tekstile;
- Të ardhura nga pikët e klientëve
- Të ardhura nga produkte elektronike;

Përgjithësisht Shoqëria për pjesën e shitjeve të sipër përmendura operon me pagesë të menjëhershme në momentin e dorëzimit të produktit tek klienti.

Të ardhurat e mësipërme llogariten në bazë të numrit të artikullit të shitur, listës së çmimeve të paracaktuar dhe njihen në pasqyrën e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse kur ndodhin. Shoqëria njihet në momentin e transferimit të produkteve tek klienti, pra kur të gjitha perfitimet dhe rreziqet e produktit si dhe kontrolli mbi produktin i kalojnë klientit në momentin e pagesës.

Shoqëria nuk ka kontrata dhe shitje që kanë faktorë variabël për t'u konsideruar si psh., penalitet për vonesa në dërgime të produkteve, përfitime për shlyerje brenda një afati të paracaktuar, ndryshime në çmime të shitjes që nuk kreditohen nga furnitori etj.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.4 Të ardhurat nga kontratat me klientët (vazhdim)

Të ardhurat nga shitja e njësive të ndërtimit

Shoqëria ka lidhur kontrata shitje me klientët në të cilat premtion shiten e njësive ndërtimore (apartamente, depo, vend parkimi dhe dyqane) të cilat mund të shiten së bashku në një kontratë ose mund të shiten në mënyrë individuale. Kontratat e shitjes janë një premtim për transferimin e njësive ndërtimore në të ardhmen dhe përcaktojnë vlerën e shitjes.

Njësitë ndërtimore mund të identifikohen në mënyrë të veçantë me një çmim individual për secilën njësi ndërtimore. Çmimi i shitjes për secilën njësi ndërtimore mund të identifikohet lehtësisht. Shoqëria ka alokuar çmimin e transaksionit për secilën njësi ndërtimore në baza individuale.

Shoqëria ka gjykuar që të ardhurat për njësitë ndërtimore të njihen në momentin e marrjes në dorëzim të njësive nga klienti me anë të dokumentit përkatës të dorëzimit, sipas të cilit klienti merr përsipër të gjitha përfitimet dhe rreziqet nga pronësia e njësive si dhe zotëron fizikisht njësinë e ndërtimit. Shitja konsiderohet e përfunduar me nënshkrimin e procesverbalit të dorëzimit ose deklaratës noteriale.

Të ardhura të tjera nga kontratat me klientët

Shoqëria si pjesë të aktivitetit të saj, përfiton të ardhura edhe nga shitjet e mëposhtme të cilat mund të identifikohen si detyrime performance të vecanta të kategorizuara si më poshtë:

- Të ardhura nga tarifa me partnerët Franchise;
- Të ardhura nga marketing;
- Të ardhura të tjera;

Të ardhura nga tarifa me partnerët franchise

Kompania përfiton njëkohësisht nga partnerët e Franchise një tarifë të ardhurash për tregun tregtar të emrit të markës SPAR. Tarifa faturon në baza mujore si përqindje mbi shitjet e krijuara nga partnerët Franchise. Sipas kontratës partneri Franchise mund të blejë produkte nga Shoqëria sipas çmimeve të ofruar paraprakisht me terma pagesash prej 30 ditësh kundrejt një garancie bankare të lëshuar nga ana e partnerit në favor të Shoqërisë. Partnerët franchise nuk kanë të drejta kthimi në kontratat e tyre.

Referuar kushteve të mësipërme dhe Standartit SNRF 15 Shoqëria njih të ardhurat e saj në momentin e faturimit, pasi pronësia sëbashku me risqet dhe ekskluzivitetin e përdorimit të produkteve dhe emrit kalon tek klienti. Gjithashtu Shoqëria nuk ka risqe të mundshme financiare për arkëtimin e të drejtave të arkëtueshme pasi mund të shfrytëzohë garancinë bankare të lëshuar në favor të saj.

Të ardhura nga marketing

Të ardhura nga marketingu janë të ardhura që përfitohen për pozicionimet e produkteve brenda marketeve Spar Albania dhe të ardhura nga marrëveshjet për organizimin e shorteve me furnitorët të cilët janë pjesëmarrës në shorte të ndryshme që organizohen gjatë një viti financiar.

Të ardhura nga pikët e klientëve

Programi i Besnikërisë së Klientit "Happy" është një program i zbatuar nga Balfin Group dhe 4 kompani si anëtarë, duke filluar nga gushti 2019. Çdo klient, i pajisur me Happy Card, grumbullon pikë për çdo blerje në çdo dyqan të anëtarëve.

Klienti ka dy opsione në konvertimin e këtyre pikave në kupona: a) Kur klienti arrin 5000 pikë (të grumbulluara për blerjet e bëra në cilindo nga anëtarët), klientit i jepet opsioni për t'i kthyer pikët në kupona me vlerë totale 3000 lekë ose mund të vazhdojë të grumbullojë pikë deri në 10,000 pikë dhe automatikisht i konvertohen në kupona me vlerë totale 6,000 lekë.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.4 Të ardhurat nga kontratat me klientët (vazhdim)

Të ardhura nga pikët e klientëve (vazhdim)

Nëse pikët nuk shfrytëzohen brenda afatit, Shoqëria do të njoh si të ardhura pikët e mbledhura por të papërdorura. Nga muaji prill 2021, skema ka ndryshuar dhe sipas programit të ri kostot shpërndahen ndërmjet anëtarëve në mënyrë të drejtë nga On Solution shpk (“Banker”).

Kjo e fundit ka lidhur një kontratë me anëtarët, sipas së cilës secilit prej anëtarëve do t'i faturohet një tarifë për pikët e akumuluar nga biznesi i tyre (të përcaktuara si të ndryshme për secilin anëtar) dhe do të rimbursojë çdo kosto të shkaktuar kur shlyen kuponët në vlerën e tyre nominale.

Anëtarët nuk mbajnë përgjegjësi ndaj klientit për pikët e akumuluar dhe te pa shfrytëzuara. Në këtë mënyrë shoqëria nuk njih detyrim kontrate për pikët e akumuluar të papërdur duke qene se këto pikë janë përfshirë nga Banker në detyrimet mujore. Banker do faturojë shoqëritë për diferencën e pikeve të dhëna dhe te përdorura.

Në pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse vlera e pikëve të dhëna paraqitet si zbritje nga të ardhurat.

Të ardhura të tjera

Shoqëria njih të ardhura të tjera për faturimet e shërbimeve të transportit ndaj palëve të treta, të ardhura nga shërbimet për shitjet brenda dyqaneve Spar (Shop in Shop), të ardhura nga qiratë sipas kontratave për pasuritë e paluajtshme, të ardhura për materiale marketingu etj.

Shoqëria ka arritur në përfundimin që është në rolin kryesor në kontratat e shitjes të sipërpërmendura sepse ajo kontrollon këto produkte, shërbime apo njësi ndërtimore përpara transferimit tek klienti, ka aftësi të përcaktojë çmimin si dhe mban të gjitha risqet dhe përfitimet në raste dështimi, dëmtimi apo mospërbushje të kushteve të kontratës.

Aktiv i kontratës

Një aktiv i kontratës me klientët është e drejta për pagesë në shkëmbim të produkteve apo shërbimeve të transferuar tek klientët.

Nëse Shoqëria përmbush duke transferuar produkte apo shërbime tek një klient përpara se ai të paguajë apo përpara se pagesa të jetë e detyrueshme, njihet një aktiv i kontratës për pagesa që do përfitohen por janë të kushtëzuara nga performanca e Shoqërisë. Meqënëse Shoqëria shet kryesisht mallra me para në dorë, nuk ka aktive materiale nga kontratat me klientë.

Të drejta të arkëtueshme

Një e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për një shumë të konsiderueshme të pakushtëzuar (d.m.th. vetëm kalimi i kohës kërkohet përpara se pagesat e shumës të jenë të detyrueshme).

Detyrimi i kontratës

Një detyrim i kontratës është një detyrim për të transferuar mallra ose shërbime tek një klient për të cilat Shoqëria ka marrë një shumë nga klienti. Nëse një klient paguan këtë shumë përpara se Shoqëria të transferojë mallra ose shërbime tek klientit, një detyrim kontrate njihet kur pagesa është bërë ose e detyrueshme për t'u kryer (cilado që është më herët). Detyrimet e kontratës njihen si të ardhura kur Shoqëria përmbush apo realizon detyrimin e kontratës.

2.5 Tatimi mbi të ardhurat

Tatim mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhurat për periudhën aktuale matet me shumën që pritet të rimerret ose paguhet nga autoritetet tatimore. Legjisllacioni tatimor i përdorur për të llogaritur shumën e tatimit mbi fitimin janë ato në fuqi ose që konsiderohen të tilla, në datën e raportimit në vendet ku Shoqëria operon dhe gjeneron të ardhura të tatueshme.

Tatimi aktual mbi të ardhurat lidhur me njësitë që njohen drejtpërdrejtë në kapitalin neto, njihet në kapital dhe jo në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. Menaxhimi periodikisht vlerëson pozicionet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e aplikueshme tatimore janë subjekt interpretimi dhe krijon provigjione aty ku është e përshtatshme.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.5 Tatimi mbi të ardhurat (vazhdim)

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet si diferenca e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tatueshme korresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm.

Detyrimet e tatimit të shtyrë në përgjithësi llogariten për të gjitha diferencat e tatueshme të përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë në përgjithësi njihen për të gjitha diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatueshëm do të jetë i mundshëm në mënyrë që këto diferenca të zbritshme të përkohshme të mund të përdoren. Këto aktive dhe detyrime të tatimit të shtyrë nuk do të njihen në qoftë se këto diferenca rezultojnë nga njohja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk prek as fitimin e tatueshëm, as fitimin kontabël.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve të tatimit të shtyrë rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që të arrihet një fitim i tatueshëm i mjaftueshëm që të lejojë që një pjesë ose i gjithë aktivi të rikuperohet. Detyrimet dhe aktivet e tatimit të shtyrë maten me normën e tatimit që pritet të përdoret në periudhën në të cilën detyrimi ka ndodhur ose aktivi është realizuar, bazuar në normat e tatimit dhe legjislacionit fiskal që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit.

2.6 Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Manaxhimi gjykon që përdorimi i modelit të koston jep një paraqitje të drejtë të vlerave të aktiveve afatgjata. Shoqëria përcakton jetëgjatësinë e aktiveve bazuar në faktorët e tregut duke iu përshatur sa më shumë kushteve aktuale të të operuarit.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet.

Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisjeje.

Në momentin që një nga aktivitet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot në vijim

Shpenzimet e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitet ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur kemi siguri që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin do të rrjedhin në shoqëri dhe kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtjes ditore njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve të mëdha apo komponentë të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohen dhe pjesa e zëvendësuar ç' regjistrohet.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

Normat vjetore të amortizimit për klasat kryesore të aktiveve afatgjata materiale janë si më poshtë:

Kategoria e Aktivitet	Metoda e Amortizimit	Norma vjetore e amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e Pajisje	Vlera e mbetur	14 -25%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.6 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur del jashtë përdorimi apo shitet, ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi ose shitja. Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja (ç'regjistrimi) e aktivitetit (llogaritur si diferencë mes të ardhurave nga pakësimi dhe vlerës kontabël të aktivitetit), paraqitet në të ardhura ose shpenzime kur aktivi ç'regjistrohet.

Vlera e mbetur e aktivitetit, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen çdo periudhë financiare, duke bërë ndryshimet e nevojshme sipas rastit në fund të çdo viti financiar.

2.7 Aktivet jo-materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata jo-materiale të përfuara veçmas njihen fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare, aktivitet afatgjata jomateriale njihen me koston minus amortizimin e akumuluar, dhe zhvlerësimin e akumuluar, nëse ka.

Amortizimi

Aktivitet afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar amortizohen përgjatë jetës së tyre të dobishme ekonomike dhe vlerësohen për zhvlerësim sa herë që ka një tregues që aktivi afatgjatë jomaterial mund të jetë zhvlerësuar. Periudha dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuar, rishikohet të paktën në çdo datë raportimi.

Amortizimi

Jetëgjatësia e dobishme e aktiveve afatgjata jomateriale vlerësohet të jetë e fundme. Amortizimi llogaritet me metodën lineare përgjatë jetës së dobishme ekonomike të vlerësuar të aktiveve afatgjata jomateriale. Norma vjetore e amortizimit të aktiveve afatgjata jomateriale është 20%-25%.

Amortizimi vjetor është paraqitur nën zërin amortizime dhe zhvlerësime në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (shih shënimin Nr. 16).

2.8 Emri i mirë

Emri i mirë i njohur nga një kombinim biznesi është një aktiv që përfaqëson përfitimet ekonomike të ardhshme që rrjedhin nga aktivitetet e tjera të blera në një kombinim biznesi që nuk janë të identifikueshme individualisht dhe të njohura veçmas. Emri i mirë nuk krijon flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivitetet apo grupet e aktiveve të tjera dhe shpesh kontribuon në flukset monetare të disa njësive gjeneruese të mjeteve monetare njëherësh.

Për qëllimin e testimit vjetor të zhvlerësimit, emri i mirë u ndahet segmenteve të operimit që priten të përfitojë nga sinergjitë e kombinimeve të biznesit në të cilat lind emri i mirë dhe krahasohet me vlerën e rikuperueshme. Çdo vit, Shoqëria teston zhvlerësimin e emrit të mirë për ta krahasuar me vlerën e rikuperueshme. Shoqëria ka vendosur që për qëllime fiskale në bazë të Ligjit Nr 8438 date 28.12.1998 Per tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar, të zhvlerësojë emrin e mirë në masën 15% në përputhje me normat fiskale të aplikuara.

Shoqëria për vitin 2022 ka kryer testin e zhvlerësimit duke u bazuar në flukset e skontuara të pritshme për njësitë Hippo dhe ka rezultuar që nuk ka zhvlerësim për këtë periudhë.

2.9 Qiratë

Shoqëria merr me qira dyqane të cilat shërbejnë si pika shitje, vende magazinimi të produkteve, hapësira administrative për punonjësit si dhe automjete etj.

i. Aktiv me të drejtë përdorimi

Shoqëria njeh një aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (p.sh. data kur aktivi është i gatshëm për përdorim). Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi dhe ndonjë korigjim për rimatjet e detyrimit të qirasë.

*(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)***2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)****2.9 Qiratë (vazhdim)***i. Aktiv me të drejtë përdorimi*

Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi përfshin:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë së njohur
- çdo pagesë e kryer në ose para datës së fillimit të qirasë, pa përfshirë çdo incentivë të përfituar
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për kthimin e aktivit në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë

Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet me metodën lineare për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Nëse aktivi me qira transferohet në pronësi të Shoqërisë në fund të periudhës së qirasë ose kosto reflekton opsionin e blerjes, amortizimi llogaritet me jetëgjatësinë e dobishme të aktivit.

Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi që lidhen me ndërtesat, fasadën dhe automjetet llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë afatit të përcaktuar të qirasë.

	<u>Jeta e dobishme në vite</u>
Pika shitje dhe/ose magazinimi	1 deri në 10
Automjete	1 deri në 3
Hapësira administrative (zyra)	5

ii. Detyrimi i qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njih një detyrim të qirasë së matur me vlerën aktuale të pagesave të qirasë përgjatë periudhës së qiramarrjes.

Pagesat e qirasë përfshijnë:

- pagesat fikse (përfshirë pagesat fikse në-thelb), minus çdo stimul qiraje të marrë;
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit;
- shumat e pritshme për t'u paguar nga qiramarrësi sipas vlerës së mbetur të garancive;
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, dhe;
- pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë reflekton ushtrimin nga qiramarrësi të një opsioni për përfundimin e qirasë;

Në vlerën aktuale të pagesave të qirasë, shoqëria përdor normën rritëse të qiramarrjes në datën e fillimit të qirasë, sepse norma e implicite e qirasë nuk është e mundur të përlllogaritet. Pas datës së fillimit vlera e detyrimit të qirasë rritet duke reflektuar interesin e përlllogaritur dhe zvogëlohet me pagesat e qirasë. Vlera kontabël e detyrimit të qirasë do të rishikohet nëse ka ndonjë modifikim, ndryshim afati, ndryshim pagese ose një ndryshim në vlerësimin e opsionit të blerjes së aktivit.

Normat e interesit janë llogaritur nga normat mesatare të huamarrjes nga shoqëritë e Grupit sipas fashave të jetëgjatësisë së kontratave:

	1-2 vite	3-5 vite	6-10 vite	10-15 vite	mbi 15 vite
Lekë	6.00%	6.00%	4.50%	6.50%	6.50%
Euro	4.50 %	5.00%	5.70%	3.37%	5.50%

Pagesat që lidhen me qira afatshkurtra dhe të gjitha qiratë e aktiveve me të drejtë përdorimi me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si një shpenzim në pasqyrën e fitimeve ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qira me afat prej 12 muajsh ose më pak. Aktivet me vlerë të ulët janë aktive me një vlerë prej 5,000 Euro ose më pak.

Shoqëria si qiradhënëse

Qiratë në të cilat Shoqëria nuk transferon të gjitha risqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e aktivit janë klasifikuar si qira operationale. Të ardhurat nga qiraja kontabilizohen me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë dhe përfshihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas natyrës së operacionit. Kostot fillestare direkte gjatë negociimit dhe caktimit të një qiraje operationale i shtohen vlerës kontabël të aktivit të dhënë me qira dhe njihen përgjatë jetëgjatësisë së qirasë sipas së njejtës metodë. Qiratë e kushtëzuara njihen si të ardhura në periudhën që ato përfitohen.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.10 Inventarët

a) Inventar mallra konsumi

Inventarët mallra konsumi përbehet nga produkte ushqimore të përpunuara ose të papërpunuara, pajisje elektro-shtëpiake, të produkte te gatshme dhe tekstile.

Inventari paraqitet me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Në inventar përfshihen të gjitha shpenzimet të lidhura me blerjen, transportin, tarifat doganore dhe sigurimin e ngarkesave.

Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin përfundimtar të shitjes për inventarët minus të gjitha kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

Gjendjet e inventarëve të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor janë vlerësuar dhe paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me metodën e kostos mesatare të ponderuar të kostove të marrjes së tyre.

Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, Shoqëria vlerëson nevojën për zhvlerësim të inventarit për produkte të vjetëruara apo produkte të skaduara.

Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse atëhere kur ka faktorë objektive që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar.

b) Inventar njësi ndërtimi

Njësitë e ndërtimit mbahen si inventar dhe maten me vlerën më të vogël nga kosto historike dhe vlera neto e realizueshme (NRV). NRV është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, bazuar në çmimet e tregut në datën e raportimit minus kostot e vlerësuara të përfundimit dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për të bërë shitjen, duke marrë parasysh vlerën në kohe të parasë nëse është materiale. Kostoja e pronës së inventarit e njohur në fitim ose humbje përcaktohet duke iu referuar shpenzimet specifike të realizuara për njësinë ndërtimore të shitur dhe alokimin e çdo kostoje jo specifike bazuar në madhësinë e pronës së shitur.

2.11 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë indikacion që një aktiv mund të jetë zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë tregues, ose kur kërkohet testimi vjetor i zhvlerësimit për një aktiv, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit. Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e lartë mes vlerës së drejtë të njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare minus kostos së shitjes dhe vlerës në përdorim të aktivit, dhe përcaktohet për një aktiv individual, përveç nëse aktivi nuk gjeneron flukse monetare hyrëse që janë kryesisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të aktiveve të Shoqërisë. Kur vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën vlerës së rikuperueshme, aktivi konsiderohet i zhvlerësuar dhe vlera e tij zvogëlohet deri në vlerën e tij të rikuperueshme.

Gjatë përcaktimit të shumës në përdorim, flukset e pritshme monetare skontoohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritje para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për këtë aktiv. Në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostove të transaksionit merren në konsideratë transaksionet më të fundit në treg, nëse janë të disponueshme. Nëse nuk mund të identifikohen transaksione të tilla, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi.

Shoqëria bazon llogaritjen e vlerës së zhvlerësimit në buxhetet e hollësishme dhe llogaritjet e parashikimit të cilat përgatiten veçmas për secilën prej njësive të gjenerimit të mjeteve monetare të Shoqërisë, në të cilat janë alokuar aktivet individuale. Këto buxhete dhe parashikimet zakonisht mbulojnë një periudhë prej pesë vitesh. Për periudha më të gjata, llogaritjet një normë afatgjatë rritjeje dhe aplikohet në skontimin e flukseve monetare të ardhshme pas vitit të pestë.

Humbjet nga zhvlerësimi i operacioneve të vazhdueshme, përfshirë zhvlerësimin në inventarë, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse në ato kategori shpenzimesh në përputhje me funksionin e aktivitetit të zhvlerësuar, përveç pronave të rivlerësuar më parë, ku rivlerësimi ishte marrë në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse.

Në këtë rast, zhvlerësimi njihet gjithashtu në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse deri në shumën e ndonjë rivlerësimi të mëparshëm.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.11 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)

Për aktivet pa përjashtim të emrit të mirë, bëhet një vlerësim në secilën datë raportimi nëse ekziston ndonjë tregues që tregon që humbjet nga zhvlerësimi të njohura më parë mund të mos ekzistojnë më ose mund të jenë ulur. Nëse një tregues i tillë ekziston, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit ose të njësive të gjenerimit të mjeteve monetare. Humbjet e mëparshme të zhvlerësimit mund të kthehen vetëm nëse ka pasur një ndryshim në supozimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivitetit që nga njohja e fundit e humbjes nga zhvlerësimi.

Ky kthim është i kufizuar në mënyrë që shuma e mbartur e aktivitetit të mos e kalojë shumën e rikuperueshme të tij, dhe as të tejkalojë shumën e mbartur e cila do të ishte përcaktuar, si amortizim neto, nëse nuk do të njihej humbje nga zhvlerësimi për aktivin në vitet e mëparshme. Ky kthim njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përveç nëse aktivi mbahet me vlerën e rivlersuar të aktivitetit, rast në të cilin kthimi trajtohet si një rritje nga rivlersimi.

Aktivet e mëposhtme kanë karakteristika specifike për testimet e zhvlerësimit:

Aktivet jo-materiale

Aktivet jo-materiale me jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar testohen për zhvlerësim individual ose në nivel njësie të gjenerimit të parasë në çdo periudhë raportimi.

2.12 Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një Shoqërie dhe një detyrim financiar ose instrumenta të kapitalit për një Shoqëri tjetër.

i) Aktivet financiare

Njohja dhe matja fillestare

Aktivet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre.

Llogaritë e arkëtueshme, të cilat nuk përmbajnë një element financimi të rëndësishëm ose ato për të cilat Shoqëria ka zbatuar metodën praktike, maten me çmimin e transaksionit sic përcaktohet në SNRF 15.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, është e nevojshme të sjellë flukse të mjeteve monetare të cilat janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI)' mbi principalin e mbetur. Ky vlerësim quhet si testi VPPI dhe aplikohet në nivel instrumenti financiar.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si Shoqëria menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Modeli i biznesit përcakton nëse flukset monetare sigurohen si rezultat i arkëtimit të flukseve monetare kontraktuale, shitja e aktiveve financiare ose si rrjedhojë e të dyjave së bashku.

Matja e mëtejshme

Për qëllime të matjes së mëtejshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse me qarkullim të fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentat e borxhit);
- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pa qarkullim të fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e heqjes nga librat kontabël (instrumentat e kapitalit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.12 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Spar Albania ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë, e cila përshkruhet më me detaje më poshtë.

Aktivët financiarë me koston e amortizuar (instrumentat e borxhit)

Kjo kategori është e vetmja e aplikueshme për Shoqërinë. Spar Albania mat aktivët financiarë me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivin financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivët financiarë me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (nëse ka interes) dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivin çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivët financiarë të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme dhe paratë dhe ekuivalentët e saj.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria njih një fond për humbjet e pritshme për të gjitha instrumentat e borxhit të cilat nuk mbahen me vlerë të drejtë përmes pasqyrës e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. Humbjet e pritshme përlllogariten si diferencë midis flukseve monetare kontraktuale të pritshme sipas kontratës me flukset monetare që Shoqëria pret të marrë, të diskontuara përparësisht me normën efektive fillestare të interesit. Flukset e pritshme monetare do të përfshijnë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose përmirësimet e tjera të kredisë që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale.

Për të drejtat e arkëtueshme, dhe aktivët e kontratës, Shoqëria përdor metodën e thjeshtëzuar në llogaritjen e humbjeve të pritshme. Si rrjedhim, Shoqëria nuk ruan ndryshimet në riskun e kredisë, por përlllogarit një provigjon për llogaritjen e dyshimta bazuar mbi humbjet e pritshme të përjetshme në çdo datë raportimi.

Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar (ose, aty ku është e mundur, një pjesë të një aktivit financiar ose një pjesë të një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) fillimisht çregjistrohet (hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar të Shoqërisë) kur:

- të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivin financiar kanë përfunduar
- transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivitetit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivët e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivët e transferuara nuk çregjistrohen.

i) Aktivët financiarë

Shoqëria ka krijuar një matricë provigjoni e cila bazohet në përvojën e saj historike të humbjeve e përshtatur për faktorët e ardhshëm që janë specifikë për klientët dhe mjedisin ekonomik në të cilën ata operojnë. Gjithashtu Shoqëria në analizën e saj merr parasysh dhe marrdhënien e klientëve që janë njëkohësisht dhe furnitorë, për të cilët nuk kryhet pagesa për furnizime deri në masën e detyrimit që ata kanë kundrejt Spar Albania si klient.

Shoqëria konsideron një aktiv financiar në vështirësi për t'u arkëtuar kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë me vonesë. Megjithatë, në raste të caktuara, Shoqëria mund të konsiderojë gjithashtu një aktiv financiar me vonesë pagesë, kur informacioni i brendshëm ose i jashtëm tregojnë se Shoqëria nuk ka gjasa të marrë shumat e papaguara kontraktuale në tërësi përpara se të marrë parasysh çdo përmirësim të riskut të kredisë. Një aktiv financiar hiqet nga librat kontabël kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.12 Instrumentat financiarë (vazhdim)

ii) Detyrimet financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare, në njohjen fillestare, klasifikohen si: detyrime financiare nëpërmjet pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve, kredi dhe borxhe, llogari të pagueshme, ose si derivate të destinuar si instrumenta mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas përkatësisë. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e kredive dhe borxheve dhe llogarive të pagueshme, njihen neto me kostot direkte të transaksionit.

Detyrimet financiare të Spar Albania përfshijnë llogaritë e pagueshme, kreditë bankare dhe hua të tjera.

Matja e mëtejshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes
- kredi bankare dhe hua të tjera

Shoqëria nuk ka detyrime financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit dhe humbjes, dhe me poshtë paraqitet një përmbledhje e kredive dhe borxheve:

Kreditë dhe borxhet

Pas njohjes fillestare, kreditë dhe borxhet maten më tej me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve në momentin kur detyrimet hiqen nga librat kontabël si dhe nëpërmjet procesit të amortizimit me interesin efektiv.

Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë cdo ulje të përfutur në blerje si dhe tarifatat ose kostot që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Amortizimi me normën efektive të interesit njihet si kosto financiare në pasqyrën e fitimeve dhe të humbjeve.

Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kur nuk pritët te këtë dalje të mjeteve monetare për atë detyrim. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

2.13 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse të të ardhurave (fitim ose humbje) kur ndodhin.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

2.14 Transaksionet me palet e Lidhura

Palet e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka një ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të pales tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

2.15 Provigjonet

Të përgjithshme

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, Shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Provizione për çështje gjyqësore

Shoqëria është në proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit si palë e tretë në çështjen e ngritur nga Cosmesi Center në anën e paditësit dhe CMB Albania në anën e të paditurit për kompensimit e detyrimeve që pala paditëse pretendon nga CMB për dëmin e shkaktuar bazuar në marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara nga palët e cilësuara më sipër në vlerën 31.824 mijë lek. Meqë Almark (emri i shoqërisë Spar Albania në vitin 2015) ka blerë kuotat e CMB Albania, shoqëria Spar Albania renditet si palë e tretë në këtë proces gjyqësor. Duke u bazuar në riskun e ulët dhe faktin që në këtë proces gjyqësor Shoqëria është palë e tretë, Spar Albania nuk ka njohur një provigjon në pasqyrat financiare të vitit 2022.

2.16 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto. Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

2.17 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një numër i politikave kontabël të shoqërisë dhe shënimeve shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Drejtimi i Shoqërisë vlerësoi se vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentët të tyre, llogarive të arkëtueshmet tregtare, llogaritë e pagueshme tregtare, aktivet dhe detyrimet e tjera afatshkurtra përafrojnë vlerën e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimeve afatshkurtra të këtyre instrumenteve.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në mënyrë prospektive. Në veçanti, elemente të rëndësishme të pasigurive në vlerësim dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përfshirë në paragrafët e mëposhtëm:

(i) Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare

Një zhvlerësim ekziston kur vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parave tejkalon shumën e tij të rikuperueshme, e cila është shuma më e lartë mes vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Llogaritja e vlerës së drejtë minus kostot për shitje bazohet në të dhënat e disponueshme nga transaksionet e shitjeve në kushte normale aktiviteti për aktive të ngjashme ose nga çmime të observueshme tregu minus kostot shtesë për shitjen e aktivitetit ose njerrjen jashtë përdorimi të tij. Llogaritja e vlerës në përdorim bazohet në modelin e skontimit të flukseve monetare.

Shuma e rikuperueshme është më e ndjeshme ndaj normës së skontimit të përdorur për modelin e skontimit të flukseve të parasë, si dhe të flukseve të pritshme monetare në të ardhmen dhe normës së rritjes që përdoren për qëllime të ekstrapolimit.

(ii) Tatimi mbi të ardhurat

Drejtimi, pavarësisht pasigurisë që ofron mjedisi tatimor shqiptar dhe legjislacioni ekzistues në fuqi, beson se llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është e përshtatshme për të gjitha vitet tatimore bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimin e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme dhe se çdo auditim tatimor në të ardhmen nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultateve të operacioneve, ose në flusket e parasë. Gjithsesi, duke u bazuar në natyrën e ligjit mbi tatimin e të ardhurave, praktikat më të fundit dhe udhëzimeve përkatëse nuk është e mundur që të jemi të sigurt se pozicioni ligjor i tatimit mbi të ardhurat do mbetet i pandryshuar.

(iii) Të ardhurat nga kontrat me klientët

SNRF 15 kërkon që Shoqëritë të përdorin gjykimin e tyre, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat domethënëse gjatë aplikimit të secilit prej hapave të modelit.

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

4. STANDARDE TË REJA DHE AMENDIME

(i) Standardet e nxjerra dhe efektive për periudhën aktuale

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit financiar të mëparshëm, me përjashtim të ndryshimeve të mëposhtme të SNRF-ve më 1 janar 2022.

Ndryshimet e mëposhtme nuk kishin ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale, objektet dhe pajisjet; SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivët Kontingjente si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshime)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022 me aplikim të mëhershëm të lejuar. BSNK ka nxjerrë ndryshime me qëllim të ngushtë në Standardet SNRF si më poshtë:

- SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet) përditësojnë një referencë në SNRF 3 për Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.

- SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale (Ndryshimet) ndalon një kompani që të zbrisë nga kostoja e aktiveve afatgjatë materiale shumë e marra nga shitja e artikujve të prodhuar ndërkohë që kompania po përgatit aktivin për përdorimin e synuar. Në vend të kësaj, një kompani njih të ardhurat e tilla nga shitjet dhe kostot përkatëse në fitim ose humbje.

- SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët Kontingjente (Ndryshimet) specifikojnë se cilat kosto përfshin një kompani në përcaktimin e koston së përmbushjes së një kontrate me qëllim të vlerësimit nëse një kontratë është e rëndë.

- Përmirësimet vjetore 2018-2020 bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe shembujt ilustrues që shoqërojnë SNRF 16 Qiratë

(ii) Standardet dhe Amendamentet e lëshuara por ende të paaplikueshme dhe të pa miratuara më herët

Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme do të miratohen nga Kompania kur të hyjnë në fuqi, megjithatë, këto nuk do të kenë ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si Aktuale ose Jo Aktuale (Ndryshime)

Ndryshimet fillimisht ishin efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me aplikimin e mëhershëm të lejuar. Megjithatë, në përgjigje të pandemisë Covid-19, Bordi e ka shtyrë datën e hyrjes në fuqi me një vit, pra 1 janar 2023, për t'u dhënë kompanive më shumë kohë për të zbatuar çdo ndryshim klasifikimi që rezulton nga ndryshimet. Ndryshimet synojnë të nxisin konsistencën në zbatimin e kërkesave duke ndihmuar kompanitë të përcaktojnë nëse, në pasqyrën e pozicionit financiar, borxhi dhe detyrimet e tjera me një datë të pasigurt shlyerjeje duhet të klasifikohen si rrjedhë ose afatgjatë.

- SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikave SNRF 2: Shpalosja e politikave kontabël (Ndryshimet)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar.

- SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshime)

Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikimin më të hershëm të lejuar dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe.

- SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshime)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Në maj 2021, Bordi nxori ndryshime në SNK 12, të cilat ngushtojnë objektin e përjashtimit të njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikojnë se si kompanitë duhet të llogarisin për tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e çmontimit

Spar Albania Sh.p.k.

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare të mbyllura deri më 31 dhjetor 2022

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

- SNRF 16 Qiratë: Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthimi me qira (ndryshime)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet synojnë të përmirësojnë kërkesat që përdor një shitës-qiramarrës në matjen e detyrimit të qirasë që lind nga një transaksion shitje dhe kthimi me qira në SNRF 16, ndërkohë që nuk ndryshon kontabilitetin për qiratë që nuk lidhen me transaksionet e shitjes dhe të marrjes me qira.

Spar Albania Sh.p.k.

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare të mbyllura deri më 31 dhjetor 2022

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. TË ARDHURA NGA KONTRATAT ME KLIENTËT

Të ardhura nga kontratat me klientët në pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shitje të produkteve të konsumueshme (a)	8,658,874	7,244,538
Shitje të produkteve jo të konsumueshme (b)	516,783	517,127
Zbritje nga shitjet	(5,105)	(40,258)
Zbritje nga programi i besnikërisë (g)	(57,892)	(45,250)
	9,112,660	7,676,157
Shitje të njërive ndërtimore (c)	1,459	50,317
<i>Të ardhura të tjera nga kontratat me klientë</i>		
Të ardhura nga marketingu (d)	70,140	80,539
Të ardhura nga tarifa nga partnerët franchise (e)	55,883	45,810
Të ardhura të tjera (f)	60,185	50,543
Të ardhura nga programi i besnikërisë	-	9,216
	186,208	186,108
Totali	9,300,327	7,912,582

- (a) Shitje të produkteve të konsumueshme përmban produkteve ushqimore të përpunuara dhe jo të përpunuara, produkteve të freskëta, frutave, perimeve etj.
- (b) Të ardhurat nga produktet jo të konsumueshme përfshihen katëgoritë e elektro-shtëpiakeve, pajisjeve elektronike, tekstileve etj.
- (c) Shitja e njërive ndërtimore i referohet portofolit të pasurive të paluajtshme që tregton Shoqëria.
- (d) Të ardhura nga marketingu janë të ardhura që përfitohen për pozicionimet e produkteve dhe të ardhura nga marrëveshjet për organizimin e shorteve me furnitorët.
- (e) Të ardhurat nga partnerët franchise janë të ardhura sipas kontratëve për tarifën në përqindje në bazë të shitjeve mujore që realizojnë për produktet që Spar u tregton.
- (f) Të ardhurat e tjera përbëhen kryesisht nga të ardhurat nga furnitorët bazuar në marrëveshjet kontraktuale ndërmjet palëve, të llogaritura si tarifë në përqindje për mallrat e blera gjatë vitit kalendarik nga Spar Albania.
- (g) Zbritjet e programit të besnikërisë janë zbritje që u jepen klientëve kur ata përdorin kuponët e tyre të krijuar nga pikët e mbledhura gjatë blerjeve.

6. TË ARDHURA TË TJERA

Të ardhura të tjera në pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura të tjera (a)	34,201	8,780
Shërbimet e ofruara për furnizuesit (b)	16,145	8,729
Të ardhura nga qiratë (c)	3,149	1,832
Të ardhura nga reduktimi i kesteve të qirase (SNFR 16)	2,077	157
Të ardhura për shërbimet e transportit	8	160
Totali	55,580	19,659

- (a) Të ardhura të tjera lidhen kryesisht me rimbursimin nga kompania e sigurimit Sigal për dëmet e shkaktuara në dyqane.
- (b) Shërbimet që u ofrohen furnitorëve janë shërbimet e ndryshme të mirëmbajtjes, të ofruara për njësitë që ushtrojnë aktivitetet e tyre brenda dyqaneve të Kompanisë (Shop in Shop) dhe që paguajnë një tarifë përkatëse.
- (c) Të ardhurat nga qiratë përbëhen nga njësi ndërtimi (apartamente) të dhëna me qira për zyra deri në shitjen e tyre.

Spar Albania Sh.p.k.
Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare të mbyllura deri më 31 dhjetor 2022

(Vlerat në mijë lek, përveç kur shprehet ndryshe)

7. KOSTOT E SHITJEVE

Kosto e shitjeve në pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Produkte të konsumueshme	7,095,154	5,918,270
Produkte jo të konsumueshme	392,477	399,605
